



Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit  
Nr.07/351/01-12491  
Dt. 06.06.2017

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit duke vendosur sipas kërkesës së parashtruar nga: **Shefqet (Ymer) Beqiraj** nga Gjakova, për dhënien e Lejes së Ndërtimit për ndërtimin e objektit të kategorisë së parë, me destinim objekt i banimit individual, me etazhitet fazë B+P+1, në bazë të Ligjit për Ndërtim, Nr. 04/L-110, nenet 14, 15, 19, 20 dhe 21 si dhe Ligjit për Procedurën Administrative Nr 02/L-28 nenit 11, bien këtë:

## A K T V E N D I M

**I. I LEJOHET: aplikuesëve: Shefqet (Ymer) Beqiraj** nga Gjakova, ndërtimi i objektit të kategorisë së parë, me destinim - objekt i banimit individual, sipas Projektit Kryesor të prezantuar, në përputhshmëri me Planin Zhvillimor Urban dhe Vendimin për Kushtet Ndërtimore me nr. 07-351-2128 të datës 30.03.2017, të lëshuar nga DUMM, në ngastrat kadastrale me nr. 147/36, Z.K. Jahoc, në rrugën "Fitim Domi", në pronësi të lartë përmendurit, të cilat e kanë vijën e ndërtimit dhe rregullimit të definuar dhe të prezantuar në planin e situacionit, me të gjithë parametrat tjerë përcjellës për ndërtimin e objektit në fjalë, etazhiteti i objektit është B+P+1, me sipërfaqe të përgjithshme (bruto) të objektit **S=324.00 m<sup>2</sup>**.

Bodrumi:	(Sip,Bruto):	S= 108.00 m <sup>2</sup>
Përdhesa:	(Sip,Bruto):	S= 108.00 m <sup>2</sup>
Kati i parë:	(Sip,Bruto):	S= 108.00 m <sup>2</sup>

**II.** Hartimin e projektit me destinim: ndërtimi i objektit të banimit individual, nga pika 1 e këtij aktvendimi e ka bërë ndërmarrja private e shërbyese N.P.SH"ARCH Plus"-Viti.

**IV.** Pjesë përbërëse e këtij aktvendimi është Plan Situacioni i lokacionit me objektin sipas vijës së ndërtimit dhe rregullimit, e përshkruar në situacionin grafik për të cilin është dhënë pëlqimi përkatës nga kjo drejtori i cili është bazë për rilevimin gjeodezik të objektit nga pika 1 e këtij aktvendimi.

**V.** Investitori është i obliguar:

- Që të ruaj një ekzemplar origjinal të dokumentacionit teknik në bazë të të cilit i është dhënë kjo Leje Ndërtimi;
- Që pa pëlqimin e hartuesit të projektit kryesor dhe pëlqimin e kësaj Drejtorie, të mos bëjë asnjë ndryshim në projekt;
- Ekzekutimi i punimeve nga pika 1 e këtij Aktvendimi, të realizohet nën mbikëqyrjen e organit mbikëqyrës për realizimin e ndërtimit të objektit.
- Të lajmëroj Drejtorinë e inspektionit për ditën e fillimit të punës së paku 8(tetë) ditë para fillimit të ndërtimit, me qëllim të verifikimit dhe përcjelljes së punimeve:

**VI.** Kjo Leje Ndërtimi vlen 1(një) vit nga dita e lëshimit të këtij aktvendimi.

## A r s y e t i m

**Shefqet (Ymer) Beqiraj** nga Gjakova, me banim në rrugën "Fitim Domi" pn, ka parashtruar kërkesën pranë DUMM me nr. 07/351/01-12491 të datës 17.05.2017 për dhënien e Lejes së Ndërtimit për ndërtimin e objektit të kategorisë së parë, me destinim objekt i banimit individual, me etazhitet B+P+1, në ngastrat kadastrale me nr. 147/36, Z.K. Jahoc, në rrugën "Fitim Domi", në pronësi të lartë përmendurit, siç është përshkruar në pikën 1 të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Së bashku me kërkesën investitori e ka prezantuar edhe këtë dokumentacion:

1. Planin e Situacionit në përpjesë 1:500 të datës 20.02.2017, të punuar nga NPSH"GELI"-Gjakovë.
2. Kopjen e planit të datës 07.04.2017 në pronësi të Shefqet (Ymer) Beqiraj, të lëshuar nga Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë.
3. Çertifikaten mbi të drejtën në pronën e paluajtshme me nr. të lëndës 2003/17 të datës 07.04.2017, të lëshuara nga Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë.
4. Vendimi për Kushtet Ndërtimore, me nr. 07-351/02-2127 të datës 30.03.2017, për rregullimin e hapësirës për ndërtimin e objektit të banimit individual, në ngastrën kadastrale me nr. 147/36 ZK: Jahoc, të lëshuar nga DUMM.
5. Pëlqimin për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, me nr. 08-320-01-9892, dt.27.04.2017, nga Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.
6. Vërtetimin mbi kryerjen e obligimeve nga tatimi në pronë, nr. 430-B-438, të datës 14.04.2017.
7. Pëlqimin nga KEDS-Gjakovë, të datës 18.04.2017.
8. Pëlqimin nga K.R.U."Radoniqi", Sh.A.Gjakovë, nr.1088 të datës 14.04.2017.
9. Pëlqimin nga PTK - Gjakovë, datë 05.04.2017.
10. Vërtetimin nga KRM"Çabrati", me nr.326, dt.14.04.2017.
11. Dëshminë mbi kryerjen e obligimeve nga taksa administrative dhe tarifa rregullative për rritjen e densitetit në Postën e Kosovës, filiali në Gjakovë me datë 02.06.2017.
12. Projektin kryesor në 3 (tri) kopje, ndërmarrja private e shërbyese N.P.SH"ARCH Plus"-Viti.

**Taksa administrative dhe tarifa rregullative për rritjen e densitetit është paguar në vlerën prej 1545.28 Euro.**

### KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij Aktvendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 30 ditësh, duke u llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim. Ankesa i parashtrohet Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në Prishtinë, dhe e njëjta dorëzohet nëpërmjet kësaj Drejtorie.

#### Aktvendimi i dorëzohet:

- Investitorit,
- Drejtorisë për punë Inspektuese,
- Arhivës.

Zyrtar i Lartë për Çështje Juridike


Zenel Shabani, jur.dipl.

U.D.Drejtori

Elida Bejtullahu, inxh. e dipl.e ark.

K.K. GJAKOVË  
Z.K. : Jahoc  
Ng. nr. 147-36.

# PLAN SITUACIONI



**P = 1 : 500**

20.02.2016  
GPS  
Auto CAD 2004

Punoi : *Khelal F. Zhubi, insh. dipl. i gjeod.*

Vërtetoi : N.P.SH."GELI"  
DREJTORI

Frok Hajdaraj

